


Fondi për Kuadro

Program financimi për pozita deficitare apo menaxheriale?




1. Qëllimi i Fondit

Pas shpalljes së pavarësisë, Instituti GAP i kishte propozuar Qeverisë së Kosovës të themelojë një fond special buxhetor për të tërhequr ekspertë të fushave deficitare në shërbimin publik. Në këtë iniciativë Instituti GAP i kishte ofruar Qeverisë një analizë të detajuar mbi nevojën e krijimit të një fondi të tillë dhe mënyrën se si do duhej të funksiononte ai fond. Për ta bërë projektin më transparent, dhe për të evituar keqpërdorimin e tij, GAP kishte propozuar që fillimisht të krijohet një uebfaqe mbi Fondin për Kuadro, në të cilin do të shpjegoheshin detajet e aplikimit, pozitat e reja, dhe vetë aplikimi të bëhej online.

Kjo ide u materializua në dhjetor 2008, kur Qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e Fondit të Trurit.¹ Sipas këtij vendimi, Qeveria do të krijonte disa pozita të reja për specialistët e nivelit të lartë të cilët do të paguheshin nga 800 deri në 1,800 euro në muaj. Në vendimin e Qeverisë u tha se kriteret precize për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve do të merren nga raporti i Institutit GAP.

Në vitin e parë të funksionit të Fondit u krijuan 8 pozita, për çfarë u nda një buxhet prej 41,375 euro. Buxheti për Fondin bashkë me numrin e pozitave përfituese shkoi duke u rritur nga viti në vit. Kështu, në vitin 2014 Fondi për Kuadro kishte 222 përfitues dhe buxhet në dispozicion prej një milion euro. Mirëpo, përkundër rritjes së buxhetit të Fondit ndër vite, përfitimet mesatare brenda një viti për përfitues kanë shkuan duke rënë, siç tregon tabela në vazhdim.

Figura 1. Buxheti i Fondit për Kuadro ndër vite



¹ Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.01/48, i datës 24 dhjetor 2008. Burimi: <http://bit.ly/1vbbkFC>

Fondi për Kuadro u pezullua përkohësisht në vitin 2015. Përfundimisht, më 12 gusht 2015, Qeveria e Kosovës mori një vendim në lidhje me Fondin. Sipas vendimit nr.07/44 Qeveria ka vendosur që buxheti për Fondin për Kuadro të shkurtohet në 500,000 euro, dhe se niveli shtesë në pagë për përfituesit të jetë nga 100 deri në 500 euro në muaj. Institucionet përfituese të Fondit janë 18 ministri dhe Zyra e Kryeministrit. Pas këtij vendimi, ministrat dhe sekretarët e përgjithshëm të ministrive përkatëse kanë filluar të përpilojnë listat e pozitave përfituese të cilat më pas u dërgohen për miratim Komisionit të Fondit për Kuadro. Por, para se ky komision të miratojë pozitën e reja përfituese, Instituti GAP kërkon nga Komisioni të bëjë një vlerësim të menaxhimit të Fondit deri më sot.

2. Keqkuptimi dhe keqpërdorimi i Fondit

Në vitin 2014 nga Fondi për Kuadro kanë përfituar gjithsejtë 222 punonjës qeveritar, të cilët kanë shpenzuar një buxhet prej 736,736 euro. Niveli i pagës bashkë me shtesat për personat përfitues ka qenë nga 800 deri në 1,800 euro.²

Funksionimi i Fondit për Kuadro bazohet në Rregulloren nr. 14/2012, e cila specifikon procedurat për përcaktimin e pozitave dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve. Instituti GAP pasi ka analizuar Rregulloren nr. 14/2012³ dhe pasi ka parë shpërndarjen e pozitave përfituese në qeveri gjatë vitit 2014, ka ardhur në përfundim se me kalimin e viteve Fondi për Kuadro ka devijuar nga qëllimi i tij origjinal. Madje, të gjeturat tona tregojnë se Fondi është keqkuptuar dhe mund të jetë keqpërdorur nga ministri të ndryshme.


Disa nga të gjeturat tona tregojnë se:

- Shumica e përfituesve nuk kanë shkollim të avancuar universitar. Nga 222 zyrtarë përfitues të Fondit në vitin 2014, gjashtë janë me titull doktor shkence, 94 me titull master dhe 122 të tjerë nuk dihet nëse kanë të paktën diplomë universitare. Qëllimi i Fondit do duhej të ishte tërheqja e njerëzve me shkollim sa më të avancuar.

² Rregullorja nr.14/2012 për Funksionimin e Fondit për Kuadro, Neni 12

³ GAP ka analizuar edhe Rregulloren Nr. 03/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 14/2012

Shkalla universitare e përfituesve të Fondit



- Shumica e përfituesve të Fondit më 2014 kanë qenë njerëz të brendshëm, që kanë qenë duke punuar në ministrinë përkatëse, dhe të cilët më pas janë futur në kategorinë e përfituesve. Kjo është bërë praktikë brenda ministrive që Fondin e kanë kuptuar si një lloj shtese për t'i shpërblyer disa punonjës. Edhe kjo praktikë është në kundërshtim me idenë origjinale të Fondit, ku përmes konkurseve do të tërhiqeshin njerëz deficitar.
- Sipas Rregullores përfituesit e Fondit duhet të kenë "aftësi, ekspertizë dhe përvojën e kërkuar edhe nga sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare" (Rregullorja, neni 4. pika 1.3). Ndërkaq, pozitat e shumë përfituesve nuk janë pozita deficitare në tregun e Kosovës. Ndër pozitat përfituese janë edhe këshilltar për media, këshilltar financiar, këshilltar teknik, e kështu me radhë. Për më tepër Rregullorja kërkon që përfituesi i Fondit duhet "të vlerësohet se sa është e vështirë të përzgjedhësh personel që kanë kualifikimet dhe shkathtësitë e kandidatit dhe nivelin e zotërimit të gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera nga kandidati (Neni 12, pika 4.2).
- Në disa ministri përveç shefit të një dikasteri edhe vartësit e tij janë konsideruar si persona deficitar. Për shembull në Ministrinë e Shëndetësisë pozitat përfituese janë Kryeinspektori i Inspektoratit Shëndetësor dhe 7 inspektorë, kurse në Ministrinë e Financave ishin Drejtori i Thesarit dhe 4 zëvendës drejtor (Shih shtojcën 1).

- Ka raste kur vetë drejtorit nuk është përfitues, por zëvendës drejtori është. Për shembull në MRKS përfituese është Zëvendës Drejtor i Departamentit të Sportit, por jo edhe Drejtori.
- Pozita e inspektorit vlerësohet ndryshe nga njëra ministrit në tjetrën dhe madje edhe brenda një ministrie. Për shembull, në Ministrinë e Shëndetësisë, në kuadër të përfituesve janë të gjithë 7 inspektorët, kurse në Ministrinë e Arsimit nga 56 inspektorë vetëm një inspektor është përfitues. Është e pa qartë në bazë të çfarë kriteri është përzgjedhur vetëm një inspektor nga 56 sosh në Ministrinë e Arsimit dhe përse kanë përfituar nga Fondi vetëm inspektorët e një ministrie (Ministrisë së Shëndetësisë) e jo edhe inspektorët e ministrive të tjera?
- Në Ministrinë e Infrastrukturës në mesin e shtatë menaxherëve rajonal përfituese është vetëm pozita Menaxher Rajonal në Prizren.

3. Rekomandime

Duke marrë për bazë idenë origjinale të krijimit të Fondit për Kuadro, duke parë Rregulloren për Funkionimin e Fondit për Kuadro, duke analizuar shpërndarjen e pozitave përfituese në vitin 2014, dhe duke pasur parasysh se në ditët në vijim ministritë bashkë me Komisionin e Fondit do të aprovojnë përfituesit e Fondit për vitin 2015, Instituti GAP rekomandon:

- Komisioni për Fondin për Kuadro të bëjë fillimisht një vlerësim individual të secilit përfitues të Fondit për vitin 2014. Gjatë vlerësimit të shikohet nëse përfituesi ka plotësuar kriteret themelore të përzgjedhjes së kandidatëve (Rregullorja, Neni 4.2), sidomos sa i përket posedimit të diplomës në fushën relevante, njohjen e gjuhës angleze, dhe përvojën paraprake në atë fushë.
- Po ashtu, gjatë vlerësimit duhet të shikohet nëse përfituesi i ka arritur rezultatet specifike të përcaktuara nga ministria përkatëse (Rregullorja, Neni 4.3).
- Komisioni i Fondit të mos aprovojë pozita dhe kandidatë që janë në kundërshtim me Rregulloren. Qëllimi primar i Fondit do duhej të ishte plotësimi i pozitave deficitare për të cilat Qeveria ka nevojë.
- Lista e pozitave përfituese, bashkë me emrat e kandidateve dhe nivelin e shtesës duhet të jetë publike.
- Fondi për Kuadro nuk duhet të kuptohet si një lloj shtese financiare për një numër të caktuar të shërbyesve civil (drejtorët e departamenteve, zëvendësdrejtorët dhe udhëheqësit e divizioneve). Ata janë punonjës të brendshëm të qeverisë, të cilët edhe ashtu janë pajtuar me pozitën dhe përfitimet që sjellin ato pozita. Ky nuk ka qenë qëllimi i krijimit të Fondit dhe aq më tepër nuk ka qenë i paraparë në raportin e Institutit GAP, në bazë të së cilit është krijuar ky fond.

4. Shtojca 1: Pozitat përfituese nga Fondi për Kuadro në vitin 2014 sipas ministrive

Organizata buxhetore	Pozitat përfituese
Zyra e Kryeministrit	Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik
	Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave
	Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave
	Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave
	Drejtor i Zyrës Ligjore
	Bakteriolog – AVUK
	Patolog – AVUK
	Koordinatorë për Integritim Evropian
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
	Drejtor i Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë
	Drejtor i Departamentit të Administratës së Arsimit Parauniversitar
	Ekspert në Qendrën për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë
	Udhëheqës i Qendrës së Kosovës për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsimin e Lartë, Shkencë dhe Teknologji
	Udhëheqës i Divizionit për Standarde dhe Vlerësim
	Drejtor i Departamentit të Inspektimit të Arsimit
	Zyrtar i Divizionit për Standarde dhe Vlerësim
	Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Diplomave dhe Dokumenteve Parauniversitare
	Udhëheqëse e Divizionit për Arsim me Nevoja të Veçanta
	Inspektore e Arsimit
	Udhëheqëse e Divizionit për Arsim të Përgjithshëm
	Udhëheqëse e Divizionit për Arsim të Komuniteteve
Hulumtues për Standarde dhe Vlerësim	
Ministria e Drejtësisë	Drejtor i Departamentit për Persona të Zhdukur
	Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
	Drejtor i Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave
	Udhëheqës i Divizionit për Integritim Evropian
	Udhëheqës i Divizionit për Politika dhe Legjislacion
	Udhëheqës i Divizionit për Përfaqësim Gjyqësor

	Udhëheqëse e Laboratorit të Toksikologjisë
	Hetues Mjekësor i Vdekjes
	Udhëheqës i Divizionit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative
	Zyrtare e Lartë Ligjore
	Zyrtare e Lartë Ligjore
	Zyrtare e Lartë Ligjore
	Zyrtare Ligjore
	Udhëheqës i Divizionit për Shitjen e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar
	Drejtor i Departamentit për Pranimin, Ruajtjen e Vlerës dhe Vlerësimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar
	Zyrtar i Lartë Ligjor
	Zyrtare e Lartë Ligjore
	Udhëheqës i Divizionit për Profesione të Lira
Ministria e Financave	Shef i Njesisë së PPP-së
	Këshilltar për Media - Njësia e PPP-së
	Këshilltare Ligjore - Njësia e PPP-së
	Këshilltar Teknik - Njësia e PPP-së
	Këshilltar Financiar - Njësia e PPP-së
	Këshilltare për Makroekonomi - Njësia e PM-së
	Këshilltare për Makroekonomi - Njësia e PM-së
	Këshilltar për Makroekonomi - Njësia e PM-së
	Analist Financiar - Njësia e PPP-së
	Drejtor i Njesisë së Buxhetit Qendror
	Drejtor i Njesisë së Buxhetit Komunal
	Analist i Lartë për Politika Fiskale
	Drejtor i Thesarit
	Zëvendës Drejtor i Thesarit
	Zëvendës Drejtor i Thesarit
	Zëvendës Drejtor i Thesarit
	Zëvendëse Drejtore e Thesarit
	Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

	Drejtor i Departamentit të Tatimit në Pronë
	Analiste e Lartë për Politika Fiskale
	Përgjegjës i Zyrës së Parë - Thesari
	Përgjegjës i Zyrës së Mesme - Thesari
	Përgjegjës i Zyrës së Pasmë - Thesari
	Analist për Makroekonomi - Njësia e PM-së
	Analist për Makroekonomi - Njësia e PM-së
	Këshilltar për Zbatim të Projekteve të PPP-së
Ministria e Shëndetësisë	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit Strategjik
	Zyrtare për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues
	Zyrtare e KPSH-së
	Zyrtar i Lartë për Harmonizim me Asquis Communautaire
	Zyrtare për Vlerësim dhe Planifikim të Nevojave Shëndetësore
	Kryeinspektor i Inspektoratit Shëndetësor
	Inspektor
	Inspektore
	Inspektore
	Inspektor
	Inspektore
	Inspektore
	Inspektore
	Shef i Divizionit të Shëndetit Publik
	Udhëheqës për Menaxhim Strategjik
	Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian
Zyrtare e Lartë Ligjore	
Zyrtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar	
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Kryeshef Ekzekutiv - APIK
	Kryeshef - ARB
	Drejtor i Akreditimit
	Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Zyrtar për Vëzhgimin dhe Rregullimin e Përpunuesve të Naftës dhe Derivateve të Saja
	Udhëheqës i Divizionit për Politika dhe Strategji
	Zyrtar për Mbrotjen e Konsumatorit
	Zyrtar i Lartë për Standarde
	Zyrtar i Lartë për Pronësi Industriale
	Zyrtare e Lartë për Analiza të Tregut dhe Politikave Tregtare
	Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë
	Zyrtar i Lartë i Politikave Zhvillimore dhe Projekteve
	Zyrtare e Lartë për Promovim të Investimeve
	Zyrtar i Lartë për Promovim të Investimeve
Ministria e Infrastrukturës	Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore
	Drejtor i Drejtorisë së Rrugëve
	Udhëheqës i Divizionit për Projekte
	Gjeodet
	Menaxher Rajonal në Prizren
	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit
Ministria e Integritimit Evropian	Zyrtare e Lartë për Koordinimin e Asistencës së BE-së
	Zyrtare e Lartë për Tregun e Brendshëm
	Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Ekonomik dhe Social
	Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë
	Zyrtare e Lartë për Arsim
	Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Koordinim
	Zyrtare e Lartë për Mjedis
	Drejtor, Departamenti i së Drejtës së BE-së
	Zyrtare e Lartë për Koordinimin e Asistencës së BE-së
	Drejtor, Departamenti i Asistencës Zhvillimore
	Udhëheqës i Divizionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
	Udhëheqës i Divizionit, Mjedisit, Energjisë dhe Transportit

	Drejtor, Departamenti i Kritereve Ekonomike dhe Tregut të Brendshëm
	Zyrtare e Lartë për çështje Shëndetësore
	Zyrtare e Lartë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
	Zyrtar i Lartë Ligjor për Legjislacion të BE-së
	Udhëheqëse e Divizionit të Tregut të Brendshëm dhe Tregtisë
	Zyrtar i Lartë për Financa dhe Statistika
	Drejtor, Departamenti i Kritereve Politike
	Drejtori, Departamenti i Politikave Sektoriale
	Zyrtare e Lartë për Politika Sociale
	Drejtor, Departamenti i Koordinimit të PSA-së
	Zyrtare e Lartë për Tregun e Brendshëm
Ministria e Administratës Publike	Drejtor i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil
	Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Koordinator për E- qeverisje
	Udhëheqës i Divizionit për Integritet Evropian
	Udhëheqës i Divizionit të Politikave të Pagave dhe Organizim Funkcional
	Udhëheqëse e Divizionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore - DASHC
	Udhëheqëse e Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit
	Udhëheqës i Ekipit të Trajnimeve - IKAP
	Koordinator për RAP
	Koordinator për RAP
	Koordinator për RAP
	Zyrtare e Lartë për Integritet Evropian
	Zyrtar i Lartë Ligjor
	Zyrtar i Lartë për Koordinim të Politikave
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Drejtor i Departamentit për Përfundim dhe Trasparenca Komonale
	Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim

	Rajonal
	Drejtori i Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave
	Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave
	Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkufitar
	Udhëheqës i Divizionit për Ngritje të Kapaciteteve në Komuna
	Udhëheqëse e Divizionit për Integritim Evropian
	Udhëheqëse e Divizionit për Avancim të Buxheteve Komunale
	Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve
	Udhëheqës i Divizionit për Zbatim të Legjislacionit
	Zyrtar për Koordinim të Politikave
	Zyrtar i Lartë për Monitorimin e Komunave
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtoresha e Departamentit të Zhvillimit të Politikave Rurale
	Drejtor i Departamentit të Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
	Drejtoresha e Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave
Ministria e Punëve të Jashtme	Drejtor i Departamentit për Çështje Rajonale
	Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm
	Zyrtar i Lartë për Sektorin e Evropës
	Zyrtar i Lartë për BE dhe Nato
Ministria e Punëve të Brendshme	Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Legjislacionit
	Zyrtar i Lartë Ligjor për Legjislacion të BE-së
	Zyrtar i Lartë Ligjor
	Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit
	Udhëheqëse e Divizionit për Integritim Evropian
	Udhëheqës i Divizionit për Sigurim të Aviacionit Civil
	Zyrtar i lartë për Shënjim, Gjurmim, Deaktivizim dhe Shkatërrim të Armëve dhe Municionit
	Shef i Laboratorit për Ekzaminim të Kompjuterëve – Specialist i Lartë i Mbikëqyrjes
	Shef i Laboratorit për Analiza Kimike të Narkotikëve – Specialist i Lartë i Mbikëqyrjes
	Specialist i Lartë, Departamenti për Traseologji

	Forenzike
	Udhëheqës i Divizionit për Shtetësi
	Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Kërkesave, Departamenti për Ri Integrim
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Drejtor i Departamentit të Mirëqenies Sociale
	Drejtor i Departamentit të Punës dhe Punësimit
	Kryesuese e Komisionit të Aftësimeve Profesionale
	Kryesues i Divizionit të Analizave Buxhetore dhe Vlerësimit të Varfërisë
	Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
	Kryesues i Divizionit të Pagesave
	Udhëheqëse e Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit
	Kryesues i Divizionit të Punësimit
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Drejtor i Filarmonisë së Kosovës
	Drejtor i Baletit të Kosovës
	Zëvendës Drejtor i Departamentit të Sportit
	Arkeolog - Instituti Arkeologjik i Kosovës
	Drejtor i Departamentit të Rinisë
	Drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës
	Drejtor i Departamentit të Integritet Evropian
	Drejtor i Zyrës për të Drejtat e Autorit
	Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës
	Drejtor i Departamentit Ligjor
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Drejtor i Departamentit Ligjor
	Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit, Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional
	Udhëheqës i Njësisë për Politika dhe Monitorimin të Ndërmarrjeve Publike
	Udhëheqës i Departamentit të Gjeoinformacionit
	Udhëheqës i Departamentit të Energjisë
	Udhëheqës i Divizionit të BREEB
	Udhëheqës i Divizionit për Sisteme të Energjisë
	Udhëheqës i Divizionit të Minerave

	Udhëheqës i Divizionit të Strategjive Sektoriale
	Zyrtare e Lartë për Integritime Evropiane
	Udhëheqës i Divizionit të Politikave të Energjisë
Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve	Udhëheqës i Zyrës për Integritime Evropiane
	Udhëheqës i Departamentit Ligjor
	Udhëheqës i Divizionit për Projekte
	Zyrtar i Lartë Ligjor
	Drejtor i Departamentit për Menaxhimin dhe Monitorimin e Projekteve
Ministria e Diasporës	Udhëheqës i Departamentit Ligjor
	Udhëheqëse e Departamentit për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore
	Udhëheqës i Divizionit për Arsim
	Drejtor i Departamentit për Hulumtime dhe Përkrahje të Investimeve në Diasporë
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Drejtor i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit
	Drejtor i Zyrës Ligjore
	Drejtori i Shpronësimit
	Kryeinspektor – Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit
	Drejtori i Departamentit të Ujërave



Institutiti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Institutiti GAP mbështetet nga:



Ky publikim është mbështetur nga:

